



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:023722

Datë: 25.09.2018

Numri i dokumentit: 00135832

**P.nr.232/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. S. nga fshati P., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1861/2016, të datës 29.03.2017, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit gjyqësor me datë: 25.09.2018, në prezencën e Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar L. M. si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**S. S.,** nga i ati H, e ëma M, e gjinisë I, data e lindjes .... në fshatin P., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar, baba i 2 (dy) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ....

Në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së,

**L I R O H E T N G A A K U Z A**

Sepse nga data e pavërtetuar e gjer me datën 24.05.2016, në shtëpinë e tij në fshatin P., Komuna e Gjakovës, me qëllim që vetes ti sjellë përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve të K., është konstatuar që i akuzuari jashtë njehsorit elektrik me numër ..., përmes kabllos 5x6, të cilën e ka lidhur në KPO-Kuadrin kryesor kyçës dhe të njëjtën e ka futur në mur duke u lidhur direkt në rrjetin elektrik, duke penguar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar K.- Divizioni Gjakovë i ka shkaktuar dëme në shumën prej 600.48 Euro.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

E dëmtuara: K.-Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m**

### 1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1861/2016, të datës 29.03.2017, kundër të akuzuarit S. S. nga fshati P., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

I akuzuari S. S., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë.

Prokurori i shtetit Armend Zenelaj, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetua në tërësi se këtu i akuzuari S. S. nga data e pa vërtetuar e gjerë me datën 24.05.2016 në shtëpinë e tij në fshatin P. Komuna e Gjakovës, me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm jashtë njësorit elektrik me numër ... përmes kabllor 5x6 të cilën e ka lidhur në KPO dhe të njëjtën e ka futur në mur e ka penguar regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike me çka ndërmarrjes së dëmtuar K. i ka shkaktuar dëme në vlerë prej 600.48 Euro. Vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike si në aktakuzë u vërtetua nga dëshmitë e dy dëshmitarëve D. M. dhe L. M. që të dy punëtorë të K. të cilët në dëshminë e tyre treguan se gjatë kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit kanë konstatuar se i njëjti përmes një kabllor e cila nuk ka qenë e lidhur në një sor ka keqpërdorë energjinë elektrike po ashtu vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike si në aktakuzë u vërtetua edhe nga procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike me numër ... i përpiluar në shtëpinë e të akuzuarit nga zyrtarët e K. ku këtë procesverbal e ka nënshkruar djali i të akuzuarit B. S. e po ashtu gjendja faktike si në aktakuzë u vërtetua edhe nga fatura me numër ... e datës 02.06.2016, si dhe nga foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës e të cilat janë bërë në shtëpinë e të akuzuarit me datën 24.05.2016, andaj pas administrimit të këtyre provave në tërësi u vërtetua gjendja faktike sikurse në aktakuzë me numër PP/II nr. 1861/2016 të datës 29.03.2017, se këtu i akuzuari S. S. ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Andaj gjykatës i propozoi që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit po ashtu të obligohet në shpenzimet e procedurës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar K., L. M. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit si dhe gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetua në tërësi gjendja faktike e konstatuar nga zyrtarët e K., gjithashtu si palë e dëmtuar parashtrojmë kërkesën pasurore-juridike.

I akuzuari S. S. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale deri sa asnjë pajisje elektrike nuk kanë qenë të lidhura jashtë njësorit, andaj ka kërkuar nga gjykata që ta liroi nga akuza.

### 2. Konstatimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi këtë gjendje faktike:

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari S. S. në mënyrë të kundërligjshme e ka përdor, devijuar, nxjerr ose përfituar nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes nga neni 320 të KPK-së, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 3. Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari S. S., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësorë i ka administruar këto prova: ka dëgjuar dëshmitarët L. M. dhe D. M., si dhe ka administruar provat materiale të propozuara nga palët dhe atë: procesverbalit mbi konstatimin e gjendjes faktike me numër ..., të datës 24.05.2016, faturën mbi rikthimin e humbjeve në emër të konsumatorit A. S. i datës 02.06.2016, faturën me numër ..., e datës 02.06.2016, në emër të konsumatorit A. S. nga fshati P., ka shikuar foto dokumentacionin nga faqja 6 deri në 16 që gjenden në shkresat e lëndës si dhe ka dëgjuar mbrojtën e të akuzuarit S. S..

#### 3.1 Deklaratat e dëshmitarëve

3.1.1 Dëshmitari L. M., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se: punoj që 5 (pesë) vite në K.-Distrikti në Gjakovë, në sektorin teknik për kontrollimin e humbjeve. Me datën 23.05.2016 kemi qenë në kontroll rutinor në fshatin P. së bashku me kolegët D. M. dhe Nd. Dh. me të cilët kemi kontrolluar njehsorët në bazë të emrave dhe ndër ta ka qenë edhe njehsori me emrin e A. S. Fillimisht pra me datën 23 kemi qenë një ditë përpara tek konsumatori për kontroll dhe aty në shtëpi kemi takuar një grua e cila na ka lejuar që të bëjmë kontrollimin e njehsorit. Gjatë kontrollit hasur dy kablllo të kyçura në KPO (kuadri kryesor kycës), ku njëra furnizonte njehsorin elektrik kurse për tjetrën ajo gruaja nuk na ka lejuar që të hyjmë brenda në objekt që të kontrollojmë mbrapa kuadrin kryesor kycës me arsyetimin se pa pasur burra në shtëpi nuk ju lejoj të hyni. Atë ditë ne kemi bllobur KPO-në dhe i kemi treguar se vijmë përsëri. Të nesërmen me datë 24.05.2018 bashkë me D. dhe N. kemi shkuar përsëri dhe kemi aty takuar një djalë me sa më kujtohet emri i tij ka qenë B., të cilin e kam cekur edhe në procesverbal. I njëjti na ka lejuar që të bëjmë kontrollimin në objekt ku kemi hasur në një mur i cili ka qenë i lyer rishtas, pra ka qenë i rregulluar ashtu që e kemi pyetur se a mund ta thyejmë. Me leje të konsumatorit e kemi thyer murin në të cilin kemi hasur në kabllon e cila kishte qenë e eliminuar nga konsumatori dhe ishte mbyllur prapë. Në dy kallot e hasura, njëra ka qenë për furnizimin e njehsorit ndërsa tjetra ka qenë jashtë njehsorit, në momentin që e kemi hasur në kabllon jashtë njehsorit, kjo kablllo ka qenë e eliminuar, pra ka qenë e këputur dhe nuk ka qenë në furnizim të asnjë pajisje të cilat i kemi cekur në procesverbal. Por në këto pajisje i kemi cekur ngase jemi të obliguar që ti cekim në procesverbal. Ai ka theksuar se ditën e parë kur kemi bërë kontroll me datën 23 KPO-ja nuk ka qenë e bllobuar ndërsa njehsori ka qenë i bllobuar. Po ashtu ai ka sqaruar se kur KPO-ja është e bllobuar, këputjen e kablllos mund të bëjë vetëm një person me profesion elektrikist, cili do kishte mundur që të ndërhynte në eliminimin e kablllos edhe pas bllobimit. Ai më pas ka theksuar se konsumatori ka mundur të keqpërdor duke i furnizuar pajisjet elektrike, por kablllo që e kemi hasur në mur ka qenë e këputur dhe kur e kemi hapur murin dhe ajo kablllo ka qenë e ndërprerë aty, ashtu që konsumatori ka pasur mundësi që të ketë pasur ndonjë prizë apo ndërprerës apo tabelë të siguresave me parë, por këto mjete e cekur në procesverbal nuk janë gjetur në ditën kritike e pra në momentin e kontrollit kur e kemi hasur kabllon e këputur nuk ka qenë duke i furnizuar ato mjete.

3.1.2 Dëshmitari D. M., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se: punoj që 4 (katër) vite në K.- Distrikti në Gjakovë, si zyrtar për zvogëlimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe këtë në teren, me datën 23.05.2016 kemi qenë në kontroll rutinorë në fshatin P., Komuna e

Gjakovës, së bashku në ekip me N. D. dhe L. M.n, ashtu që kemi bërë kontroll edhe tek konsumatori A. S.. Pasi që kemi kontrolluar njehsorin elektrik dhe KPO-në, në KPO kanë ekzistuar dy kablllo 5x6 dhe i kemi treguar se njëra është jo në rregull, pasi ajo nuk na ka lënë të hyjmë brenda ne e kemi bllobuar KPO-në duke i treguar se nesër do të vijmë prapë duke i thënë të mos e këpusin bllobën e KPO-së. Të nesërmen kemi shkuar, e kemi këputur bllobën e KPO-së dhe aty i kemi hasur dy kabllot si ditën e parë, pasi kemi hyrë brenda në brendësinë e murit ku ka qenë KPO-ja e vendosur përbrenda, muri ka qenë i lyer rishtas, pasi kemi pyetur se a mund ta thyejmë murin, pasi e kemi thyer murin e kemi verifikuar se cila kabëll shkon tek njehsori ndërsa kabllin tjetër e kemi eliminuar prej KPO-së. Ai ka theksuar se personi shoqërues B.ka qenë tërë kohës me ta dhe ka sjellë edhe një mjet teslicë, për ta thyer murin dhe po ashtu i njëjti e ka nënshkruar procesverbalin. Në momentin kur e kemi gjetur kabllon ajo nuk ka qenë duke furnizuar ndonjë aparat apo pajisje por vetëm ka qenë e vendosur në mur dhe në brendësi të objektit. Ne kemi për obligim që në fund të kontrollit ti cekim pajisjet që kanë qenë në objekt të shënohen në procesverbal mirëpo pajisjet që janë të shënuara në procesverbal në momentin kur e kemi gjetur kablllo nuk ka qenë duke i furnizuar këto pajisje. Ai ka treguar që kablllo e lidhur jashtë njehsorit ka qenë e lidhur e energjenzuar mirëpo pasi është gjuajtur mallteri nuk mund të vërehet se a ka qenë izolimi i kablllove i ri apo i vjetër. Ai ka theksuar se kablllo ka qenë e lidhur në KPO mirëpo prej kur ka qenë e lidhur nuk e di. Kjo kablllo e gjetur në mur ka qenë e këputur e izoluar dhe e mbyllur me mallter dhe mund të keqpërdoret në forma të ndryshme duke u vendosur si një prizë tre fazore apo të bartet në prizë mbas njehsorit por në ditën kritike nuk e kemi gjetur në këtë formë.

### 3.2 Provat materiale

3.2.1 Nga leximi i procesverbalit mbi konstatimin e gjendjes faktike me numër ... i datës 24.05.2016, gjykata ka konstatuar se në këtë procesverbal është treguar gjendja e njehsorit të tipit T-31cdv, me tarifën e I-rë me numër 26360 dhe tarifën e II-të me numër 11492, me numër të njehsorit ..., me numër të plemes A-50008392 dhe punëtorët e autorizuar të K. gjatë kryerjes së detyrë zyrtare në vendin e ngjarjes kanë konstatuar gjatë kontrollimit me datën 23.05.2016, konsumatori nuk ishte prezent, në KPO ishin 2 (dy) kablllo 5x6, njëra ishte jashtë njehsorit. KPO-ja është bllobuar me datën e lartpërmendur dhe me po këtë datë është kontrolluar objekti brenda ku është vërtetuar se kablllo ishte e këputur, në KPO ekziston kablllo por ajo ishte e mbyllur. Në murin e objektit ishte intervenuar duke e thyer dhe duke e eliminuar KPO-në dhe duke e bllobuar njehsorin. Po ashtu në këtë procesverbal janë konstatuar të gjitha pajisjet elektrike të cilat i ka pasur në shtëpinë e tij i akuzuari.

3.2.2 Nga leximi i faturës mbi rikthimin e humbjeve në emër të konsumatorit A. S. i datës 02.06.2016, gjykata ka konstatuar se me anë të kësaj fature është bërë llogaritja dhe faturimi i shpenzimeve të pa autorizuar.

3.2.3 Nga leximi i faturës me numër ..., e datës 02.06.2016, në emër të konsumatorit A. S. nga fshati P., gjykata ka konstatuar se me anë të kësaj fature është përcaktuar rikthimi i humbjeve nga ana e K..

3.2.4 Nga shikimi i foto-dokumentacionit nga shikimi në dokumentacionin me numër 6 deri në 16, që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se në këto fotografi shihet njehsori elektrik me nr...., pajisjet elektrike të cilat janë hasur në shtëpinë e të akuzuarit si dhe muri i thyer dhe kablllo për brenda murit, të cilat fotografi janë bërë gjatë kontrollit në vendin e ngjarjes, në shtëpinë e të akuzuarit S. S., në fshatin P., Komuna e Gjakovës.

### 3.3 Mbrojtja e të akuzuarit

3.3.1 I akuzuari S. S., gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se: nuk e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet sepse kjo kablllo nuk ka qenë e lidhur. Ditën e parë kur është bërë kontrolli, aty ka

qenë bashkëshortja ime, KPO-ja dhe njehsori kanë qenë të bllobuar ndërsa kabllon të cilën e kanë cekur ata nuk ka qenë e lidhur dhe ajo kablo ka qenë aty qysh prej kohës së para luftës, pa asnjë energjie cila është aty edhe sot e kësaj dite ndërsa ka kablo tjera të cilat kanë qenë të lidhura në mënyrë direkte e të cilat e furnizojnë shtëpinë kurse ajo kablo të cilët e kanë gjetur kontrollorët ka qenë jashtë njehsorit, duke mos furnizuar asgjë, e një gjë të tillë mund ta shikoni edhe sot. Ai ka theksuar se njehsori elektrik për të cilin bëhet fjalë ka qenë në emër të vëllait të tij A. S., me të cilin kanë jetuar së bashku por që pas vdekjes së tij në vitin 2010, ai ka jetuar dhe banon në atë shtëpinë, dhe se njehsori është ende emrin tij dhe nuk ka e ka bartur në emrin tij sepse nuk kam pasur ndonjë interes. Ai ka theksuar se pjesa e mbyllur e murit ku është gjetur kablo a qenë e tillë prej kohës së para luftës dhe nuk ka intervenuar për të nxjerrë kabllon nga muri pasi është dashur që i tërë muri të prishet duke treguar që është ndërruar njehsori duke u zëvendësuar me një njehsor digjital nga ana e K.. I njëjti deklaroi se për dy kabllot e gjetura në mur ka pasur dijeni K.-i ngase edhe para 7-8 viteve ka qenë në kontroll F. M. dhe drejtoresha gjeneralë dhe të njëjtëve iu kam treguar edhe atyre se njëra kablo është këputur kurse forma dhe mënyra se si është këputur nuk e di. Ata kanë kontrolluar dhe kanë konstatuar se rryma ka qenë ën rregull dhe më kanë sugjeruar që është mirë ti hiqni këtë kablo mirëpo një gjë të tillë nuk e kam bërë për shkak se më prishet muri. Kablo ka qenë këputur dhe nuk ka qenë duke furnizuar asnjë pajisje shtëpiake të përshkruar në procesverbal me anë të kësaj kabloje.

#### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 320 të KPRK, është parashikuar se veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale e kryejnë: *“Kushdo që merr, përdor, devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”*. Pra kryesi i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person, ku nënkuptohet edhe personat. Veprimet me të cilat kryhet kjo veprë penale janë paraqit në mënyrë alternative si vijon: me marrjen e pa autorizuar të shërbimit komunal, me përdorimin e pa autorizuar të shërbimit komunal, me devijimin e pa autorizuar të shërbimit komunal, me nxjerrje ne pa autorizuar të shërbimit komunal dhe përfitimi i pa autorizuar nga shërbimi komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes. Vepra penale kryhet vetëm me dashje përgjegjës ose të autorizuar.

#### 5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata pasi që ka analizuar të gjitha provat në rastin konkret ka konstatuar se me date 23.05.2016, fillimisht kontrollorët e K., këtu dëshmitarët L. M.dhe D. M. kishin pasur për detyrë që ti kontrollojnë konsumatorët në fshatin P., Komuna e Gjakovës, ashtu që kanë shkuar që të bëjnë kontrole edhe në shtëpinë e të akuzuarit S. S.. Meqenëse atë ditë kontrollorët e K., gjatë kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit kanë vërejtur se ekzistojnë dy kabllot të kyçura në KPO. Të njëjtit atë ditë nuk kishin bërë kontroll brenda në shtëpisë së të akuzuarit për shkak se bashkëshortja e të akuzuarit iu kishte thënë se nuk ka ndonjë mashkull në shtëpi dhe mund të hyni në shtëpi pa prezencën e tyre. Kontrollorët e K. kishin bllobuar KPO-në ashtu që me datën 24.05.2016 sërish kishin shkuar në kontroll në shtëpinë e të akuzuarit ku kishin takuar djalin e të akuzuarit B. S., ashtu që i njëjti i kishte lejuar që të bëjnë kontroll brenda shtëpisë ashtu që kontrollorët përkatësisht dëshmitarët kishin dyshuar në një pjesë të murit se mund të jetë kablo e cila ka qenë e lidhur jashtë njehsorit ashtu të njëjti e kanë thyer murin dhe kanë hasur në kablo. Në momentin kur kishin hasur në kablo ajo kishte qenë e eliminuar (pra kishte qenë e këputur) dhe kablo nuk ka qenë duke i furnizuar asnjë pajisje elektrike të cilat janë përshkruar në procesverbalin e gjendjes faktike por e njëjta kishte e qenë e lidhur nga KPO dhe kishte qenë brenda murit e eliminuar (pra kishte qenë e këputur) dhe e izoluar. Kjo gjendje është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit L. M., të cilit gjykata i ka falur besimin ngase është

punëtor i K., e po ashtu vet ai kishte bërë kontrollin ditën kritike ashtu që i njëjti ka deklaruar se: *“Me leje të konsumatorit e kemi thyer murin në të cilin kemi hasur në kabllon e cila kishte qenë e eliminuar nga konsumatori dhe ishte mbyllur prapë. Në momentin që e kemi hasur në kabllon jashtë njehsorit, kjo kabllo ka qenë e eliminuar, pra ka qenë e këputur dhe nuk ka qenë në furnizim të asnjë pajisje të cilat i kemi cekur në procesverbal. Konsumatori ka mundur të keqpërdor duke i furnizuar pajisjet elektrike, por kabllo që e kemi hasur në mur ka qenë e këputur dhe kur e kemi hapur murin dhe ajo kabllo ka qenë e ndërprerë aty, ashtu që konsumatori ka pasur mundësi që të ketë pasur ndonjë prizë apo ndërprerës apo tabelë të siguresave me parë, por këto mjetet e cekur në procesverbal nuk janë gjetur duke i furnizuar përmes kabllor. Këtë gjendje gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit D. M. të cilit gjykata po ashtu ia ka falur besimi për shkak është punëtor i K., e po ashtu edhe ky kishte bërë kontrollin ditën kritike dhe po ashtu se dëshmia e tij është në harmoni me dëshminë e dëshmitarit L. M. t ashtu që dëshmitari D. M. ka deklaruar se: *“pasi e kemi thyer murin e kemi verifikuar se një kabllo shkon tek njehsori ndërsa kabllon tjetër e kemi eliminuar prej KPO-së. Kabllon të cilën e kemi gjetur nuk ka qenë duke furnizuar ndonjë aparat apo pajisje por vetëm ka qenë e vendosur në mur dhe në brendësi të objektit mirëpo ne kemi për obligim që në fund të kontrollit ti cekim pajisjet që kanë qenë në objekt dhe të shënohen në procesverbal mirëpo pajisjet që janë të shënuara në procesverbal në momentin kur e kemi gjetur kabllon nuk ka qenë duke u furnizuar përmes kësaj kabllorje. Prandaj gjykata ia ka falur besimin e plotë të akuzuarit S. S., i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet e i cili ka deklaruar se kjo kabllo ka qenë qysh prej kohës së paraluftës dhe me këtë kabllo nuk ka qenë duke e furnizuar asnjë pajisje elektrike në shtëpinë e tij. Mbrojtjes së tij ia ka falur besimin për faktin se mbrojtja e tij është bindëse, e sinqertë dhe e logjikshme dhe është në harmoni edhe me provat tjera që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësorë por dhe dëshmitë e dëshmitarëve L. M. dhe D. M. të cilët kanë deklaruar se *“lidhja ka ekzistuar dhe kabllo ka qenë brenda murit, e mbyllur me mallter dhe e cila kabllo ka qenë e eliminuar (e këputur) dhe njëjta nuk ka qenë duke furnizuar me energji asnjë pajisje në shtëpinë e të akuzuarit, të cilat pajisje janë cekur në procesverbalin gjendjes faktike.***

Duke pas parasysh të gjitha këto rrethana, fakte të shqyrtuara dhe me provat e vërtetuara, gjykata morri aktgjykim lirues për faktin se aktakuza ka mbetur në nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo të bazuar mirë në prova të artikulushme dhe të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet. Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka theksuar se është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale pasi që në shtëpinë e tij në fshatin P. Komuna e Gjakovës, me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm jashtë njehsorit elektrik me numër ... përmes kabllor 5x6 të cilën e ka lidhur në KPO dhe të njëjtën e ka futur në mur e ka penguar regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike me çka ndërmarrjes së dëmtuar K. i ka shkaktuar dëme në vlerë prej 600.48 Euro, por gjykata ka ardhur në përfundim se ky pretendim i prokurorisë nuk qëndron ngase nga të gjitha provat e administruara nuk është vërtetuar fakti se si akuzuari përmes kësaj kabllor e kishte penguar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike, kur e njëjta ditën kritike është gjetur brenda murit e eliminuar (pra e këputur) duke mos furnizuar asnjë pajisje elektrike të cilat kanë qenë brenda shtëpisë, prandaj nuk ka mundur të vërtetojë faktin se i akuzuari e ta ketë përdorë dhe ti ketë shkaktuar dëmin të dëmtuarës siç pretendohet me akuzë ngase edhe me vetë dëgjimin dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria gjykata nuk mundur të vërtetojë se i akuzuari këtë kabllo e kishte shfrytëzuar-përdorur ngase dëshmitarët L. M. dhe Dedë M. që të dy kanë deklaruar së: *kabllo ka qenë e eliminuar (e këputur) dhe nuk ka qenë duke furnizuar asnjë pajisje që janë konstatuar në procesverbalin e gjendjes faktike, por i njëjti më parë ka mundur që të ketë keqpërdor përmes kësaj kabllor duke vendosur përmes prizës apo ndonjë mjeti tjetër por në momentin kur është bërë kontrolli kjo kabllo ka qenë e këputur dhe pa furnizim dhe nuk ka furnizuar asnjë nga mjetet e lartcekura, prandaj edhe gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se si i akuzuari ka penguar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike kur kabllo ka qenë brenda murit, ka qenë e eliminuar (pra e këputur) dhe njëjta nuk ka qenë duke furnizuar me energji*

asnjë pajisje në shtëpinë e tij, prandaj pretendimi se ai më parë ka mundur ta ketë keqpërdorshfrytëzuar duke i furnizuar pajisjet elektrike, gjykata duke u bazuar në parimin “*IN DUBIO PRO REO*” nenin 3 par.2 të KPP-së, në cilin është përcaktuar se “*mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, në mungesë të provave duke u bazuar në nenin 364 par.1 pika 1.3 të KPP, të akuzuarin S. S. e ka liruar nga akuza për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

#### 6. Vendimi për lirim të akuzuarit nga akuza

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në nenin 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP gjyqtari i vetëm gjykues e liroi nga akuza të akuzuarin S. S., për kryerjen e veprës penale, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.3 të KPP-së.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar në nenin 454 par.1 të KPP-së.

Duke u bazuar në arsyet që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.232/17, me datë 25.09.2018**

**Procesmbajtësja,**  
**Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.